



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	08.11.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	OJQ “Syri i Vizionit”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga OJQ “Syri i Vizionit” me përfaqësues Naser Lajqi me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi, “Skënderbeu” me datë 10 dhe 11 Nëntor 2021 nga ora 10:00. Qëllimi i kërkesës është realizimi i fushatës sensibilizuese me moton “ Dhuna nuk ka Justifikim” si pjesë e fushatës së promovimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, ku do të bëhet vendosja e instalacionit “8 Silueta” me gjatësi 15.m dhe gjerësi 1m. Ky instalacion do të qëndroj në shesh nga data 10.11.2021 deri me datë 12.11.2021.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ “Syri i Vizionit” për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “ Skënderbeu” me datë 10 dhe 11 Nëntor 2021 me qëllim që të rritet vetëdija e shoqërisë në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimin trupor ndaj fëmijëve. Instalacioni do të qëndroj në shesh nga data 10 deri me datë 12 Nëntor 2021.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.